



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-100

PËR NDIHMËN SHTETËRORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDIHMËN SHTETËRORE

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe procedurat, kushtet e përgjithshme si dhe rregullat për autorizimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore.
2. Ky ligj pjesërisht është në përputhje me Rregulloren e BE-së 2015/1589, e datës 13 korrik 2015, për përcaktimin e rregullave të detajizuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve që veprojnë në Republikën e Kosovës, me përjashtim të sektorëve të agrikulturës dhe të peshkimit, përfshirë këtu edhe produktet e përpunuara agrikulturore.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Ndihma shtetërore** - çdo shpenzim aktual apo shpenzim i mundshëm, apo reduktim i të ardhurave të shtetit, e dhënë në çfarëdo forme nga ana e dhënësit ose që mund t'i atribuohen shtetit, e cila drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë shtrembëron ose rrezikon ta shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar përfitues të caktuar të ndihmës shtetërore ose prodhime të mallrave dhe shërbimeve të caktuara, dhe që bie ndesh me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij ligji;

1.2. **Dhënësit e ndihmës shtetërore** - Republika e Kosovës nëpërmjet të gjitha organeve të autorizuara të administratës qendrore dhe të qeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, apo ndonjë autoritet tjetër që vepron në emër të shtetit dhe jep ndihmë shtetërore;

1.3. **Përfituesit e ndihmës shtetërore** - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike, të cilët në këtë mënyrë marrin pjesë në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, dhe marrin një formë të ndihmës shtetërore;

1.4. **Skema e ndihmës** - nënkupton:

1.4.1. Çdo akt mbi bazën e të cilit, pa zbatimin e mëtejshëm të masave tjera të nevojshme, mund të bëhet dhënia e ndihmës individuale për ndërmarrjet e përcaktuara në akt në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte; dhe

1.4.2. Çdo akt në bazë të të cilit, ndihma e cila nuk është lidhur me një projekt të veçantë, mund të jepet për një ose disa ndërmarrje për një periudhë të pacaktuar kohore dhe/ose për një shumë të pacaktuar.

1.5. **Ndihma shtetërore individuale** - çdo ndihmë shtetërore e cila nuk është dhënë në bazë të skemës së ndihmës shtetërore dhe çdo ndihmë shtetërore e dhënë në bazë të skemës së ndihmës shtetërore, e cila është subjekt i autorizimit shtesë;

1.6. **Ndihmë e kundërligjshme** - çdo ndihmë shtetërore e dhënë ose e zbatuar pa njoftimin dhe autorizimin e Komisionit;

1.7. **Palët e interesit** - çdo person, ndërmarrje ose asociacion i ndërmarrjeve, interesat e të cilave mund të preken nga dhënia e ndihmës shtetërore;

1.8. **Njoftimi për ndihmën shtetërore** - kërkesa që i paraqitet Komisionit nga dhënësi i ndihmës, për miratimin e skemës së ndihmës shtetërore apo ndihmës individuale, e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në këtë Ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, para dhënies së ndihmës shtetërore;

1.9. **Skemat ekzistuese të ndihmës shtetërore** - akti në bazë të të cilit ndihma shtetërore është autorizuar ose dhënë para se ky ligj të hyjë në fuqi;

1.10. **Ndihma “De Minimis-** ndihmë me vlerë të vogël që nuk konsiderohet ndihmë shtetërore dhe nuk është subjekt i njoftimit dhe autorizimit të Komisionit.

1.11. **Ndihmë e re** - çdo ndihmë, skemë e ndihmës shtetërore apo ndihmë individuale, e cila nuk është ndihmë ekzistuese, përfshirë këtu edhe ndryshimet në ndihmat ekzistuese; dhe

1.12. **Keqpërdorim i ndihmës** – shfrytëzimi i ndihmës shtetërore nga përfituesi i ndihmës shtetërore në kundërshtim me autorizimin e Komisionit.

Neni 4

Ndalimi i përgjithshëm i ndihmës shtetërore

Çdo ndihmë shtetërore, në kuptimin e paragrafit 1.1 të nenit 3 të këtij ligji, e dhënë nga dhënësi i ndihmës shtetërore pa marrë parasysh formën, është ndihmë e ndaluar, përveç nëse është paraparë ndryshe me këtë ligj.

Neni 5

Ndihma e lejueshme

1. Përrjashtimisht nga neni 4 i këtij Ligji, ndihmat e mëposhtme janë në përputhshmëri me këtë Ligj dhe nuk janë të kushtëzuara me aprovimin paraprak të Komisionit:

1.1. Ndihma e karakterit social, që u jepet konsumatorëve individual, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek; dhe

1.2. Ndihma për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga ngjarjet e jashtëzakonshme.

Neni 6

Përputhshmëria e kushtëzuar e ndihmës shtetërore

1. Ndihmat shtetërore të mëposhtme mund të konsiderohen në përputhshmëri me këtë Ligj, me kusht që paraprakisht të jenë të autorizuar nga Komisioni:

1.1. Ndihma shtetërore që jepet për të nxitur zhvillim ekonomik në rajonet e Republikës së Kosovës ku standardi i jetesës është jo normalisht i ulët dhe ku ka papunësi të theksuar;

1.2. Ndihma shtetërore që jepet për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm të Republikës së Kosovës dhe interesit evropian ose për mënjanimin e një çrregullimi serioz në ekonominë e Republikës së Kosovës;

1.3. Ndihma shtetërore që jepet për të lehtësuar zhvillimin e disa fushave apo aktiviteteve të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë sa për të rënë ndesh me interesin e përbashkët të përcaktuar me marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Kosovës; dhe

1.4. Ndihma shtetërore që promovon kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë;

2. Kushtet, kriteret dhe procedurat e vlerësimit të ndihmës shtetërore të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 7 **Ndihma “De Minimis”**

1. Në kuptim të këtij ligji, ndihma de minimis nuk konsiderohet ndihmë shtetërore dhe nuk është subjekt i njoftimit dhe autorizimit të Komisionit, me kusht që është dhënë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kriteret, fushëveprimi dhe procedurat për dhënien e ndihmave “de minimis“ përcaktohen me akt nënligjor.

3. Në përputhje me legjislacionin në fuqi të BE-së, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) përcakton limitet e ndihmës de minimis.

Neni 8 **Departamenti i Ndihmës Shtetërore**

1. Departamenti i Ndihmës Shtetërore (në tekstin e mëtejme: Departamenti), themelohet në kuadër të Ministrisë së Financave, i cili siguron asistencë profesionale dhe administrative për Komisionin lidhur me veprimet ligjore për ndihmën shtetërore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Departamenti është përgjegjës për:

2.1. vlerësimin e propozimeve individuale për ndihmë shtetërore dhe skemat e ndihmës shtetërore, si dhe hartimin e raportit vlerësues për Komisionin;

2.2. monitorimin e zbatimit të ndihmës shtetërore të dhënë dhe efekteve që krijon, si dhe propozimin e revokimit të ndihmës së kundërligjshme;

2.3. mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave për ndihmën shtetërore;

2.4. mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrit të ndihmës shtetërore;

2.5. bashkëpunimin me dhënësit e ndihmës shtetërore;

2.6. përgatitjen e draftit të Raportit Vjetor të Ndhmës Shtetërore lidhur me zbatimin e Ligjit; dhe

2.7. bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare lidhur me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në fushën e ndihmës shtetërore.

3. Përgjegjësitë e tjera, organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës, si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit, të Departamentit përcaktohen me aktin nënligjor përkatës për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Financave.

Neni 9 **Komisioni i Ndhmës Shtetërore**

1. Komisioni i Ndhmës Shtetërore (Komisioni) është organi i pavarur vendimmarrës për ndihmë shtetërore, i përbërë nga pesë (5) anëtarë, ekspert të pavarur në fushën e ndihmës shtetërore.

2. Anëtarët e Komisionit kanë mandat tri (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Gjatë ushtrimit të mandatit, anëtarët e Komisionit nuk mbajnë funksione publike dhe pozita të emëruara politike.

3. Pas zhvillimit të një procesi të rekrutimit në bazë të meritës, anëtarët e Komisionit për Ndhmën Shtetërore emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit të Komisionit Përzgjedhës, i përbërë nga:

3.1. Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

3.2. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

3.3. Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Çdo kandidatë që propozohet për anëtar të Komisionit për Ndhmë Shtetërore, duhet të ketë kualifikimet dhe plotësojë kriteret vijuese:

4.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

4.2. të jetë i diplomuar në fakultetin ekonomik apo juridik, apo në fushat tjera përkatëse që lidhen me fushën e ndihmës shtetërore;

4.3. të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale fushat e drejtësisë, financave publike ose fushat tjera që ndërlidhen me ndihmën shtetërore;

4.4. të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burg për më shumë se gjashtë (6 muaj); dhe

4.5. të ketë aftësi për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me vendosmëri dhe përgjegjshmëri.

5. Anëtarët e Komisionit shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëse:

5.1. me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar për vepër penale më shumë se gjashtë (6) muaj; dhe

5.2. ka humbur aftësinë mendore apo fizike për punë;

5.3. ka kryer akte apo sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij/saj; dhe

5.4. nuk paraqitet në detyrë pa arsye për më shumë se tre (3) muaj.

6. Komisioni miraton Rregulloren e Punës, ku përcaktohet organizimi, procedurat administrative të vendimmarrjes si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit.

Neni 10 **Ruajtja e sekretit**

1. Gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës apo mandatit të tyre, zyrtarët e Departamentit dhe anëtarët e Komisionit janë të detyruar t'i ruajnë informatat dhe të dhënat e karakterit sekret, që nxirren gjatë procedurave për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, informatat e mëposhtme konsiderohen si sekrete:

2.1. të gjitha informatat e klasifikuara si sekrete në legjislacionin në fuqi;

2.2. të gjitha informatat e klasifikuara si sekretet nga aktet e brendshme të përfituesit, të cilat vlerësohen nga Departamenti; dhe

2.3. të gjitha korrespondencat e bëra me organizatat ndërkombëtare lidhur me ndihmën shtetërore, për të cilat ka pajtim me shkrim që të trajtohen si të tilla.

Neni 11

Njoftimi për ndihmë shtetërore

1. Për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore, dhënësi i ndihmës i paraqet Departamentit njoftimin e plotë për skemën e ndihmës shtetërore apo planin për ndihmën individuale, përfshirë këtu edhe për aktet normative, përveç Projektligjeve të cilat procedohen për Komente paraprake sipas nenit 12 të këtij ligji. Ndihma e njoftuar sipas këtij paragrafi nuk krijon efekt para vendimit të Komisionit për autorizimin e ndihmës.
2. Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit për ndihmën shtetërore të propozuar apo informatave shtesë, Departamenti nuk kërkon nga dhënësi i ndihmës shtetërore apo nga përfituesi informacion shtesë, konsiderohet se Departamenti ka të gjitha informatat e duhura për vlerësimin e ndihmës shtetërore.
3. Njoftimi nuk është i domosdoshëm në rastin kur ndihma individuale është dhënë sipas skemës të cilën Komisioni e ka miratuar me vendim sipas nenit 14 të këtij ligji, përveç rasteve kur vlera e ndihmës individuale duhet të njoftohet, sipas vendimit të Komisionit.
4. Kur njoftimi për ndihmë shtetërore nuk është kompletuar, Departamenti brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i njoftimit, kërkon të gjitha informatat shtesë. Në rast të mos dorëzimit të informatave shtesë brenda afatit, njoftimi për ndihmë konsiderohet i tërhequr.
5. Procedurat lidhur me njoftimin për ndihmë rregullohen me akt nënligjor.

Neni 12

Komentet me shkrim për Projektligjet që përmbajnë ndihmë shtetërore

Komisioni i Ndhmës Shtetërore ofron komente me shkrim për projektligje të cilat organet propozuese vlerësojnë se Projektligji ka elemente të ndihmës shtetërore. Komisioni ofron komentet brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga momenti i pranimit të Projektligjit. Këshillat dhe komentet e Komisionit të Ndhmës Shtetërore merren parasysh nga Qeveria e Republikës së Kosovës para miratimit të projektligjit nga ana e Qeverisë dhe dorëzimit të tij Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim përfundimtar.

Neni 13

Procedurat për vlerësim e ndihmës shtetërore

1. Pas pranimit të njoftimit për ndihmë shtetërore sipas nenit 11 të këtij ligji, Departamenti vlerëson përputhshmërinë e ndihmës shtetërore me dispozitat e këtij ligji.
2. Departamenti mund të kërkojë nga të gjithë dhënësit dhe përfituesit të gjitha informacionet për të vlerësuar ndihmën shtetërore. Informatat e siguruara nga një palë e interesit mund të shfrytëzohen, me kusht që të gjitha palët e interesit kanë mundur të komentojnë gjatë procedurës së vlerësimit.

3. Kur një çështje ngrihet në procedurat pranë Departamentit, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e legjislacionit evropian të energjisë, Departamenti, me kërkesë të një pale ose me iniciativën e saj, e njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në formë të shkruar, në afatin prej 5 (pesë) ditë pune, nga pranimi i çështjes në procedurë. Komisioni në vendimin e tij përfundimtar, duhet të marrë parasysh mendimin e dhënë nga Sekretariati.

Neni 14

Vendimi për ndihmën shtetërore

1. Pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë së ndihmës shtetërore, Komisioni merr vendim si vijon:

1.1. konstaton se njoftimi për skemën e ndihmës shtetërore apo për planin për ndihmën individuale nuk është ndihmë shtetërore;

1.2. konstaton se njoftimi për skemën e ndihmës shtetërore apo planin për ndihmën individuale është ndihmë shtetërore dhe vendos për autorizimin e kushtëzuar apo të pakushtëzuar të ndihmës shtetërore; apo

1.3. konstaton se njoftimi për skemën e ndihmës shtetërore apo planin për ndihmën individuale është ndihmë shtetërore e ndaluar dhe nuk e autorizon atë.

2. Vendimi i Komisionit për autorizimin e ndihmës merret:

2.1. brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të njoftimit të kompletuar për ndihmën e propozuar, në rastet e shqyrtimit të planeve të reja për ndihmë shtetërore;

2.2. brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data e pranimit të njoftimit të kompletuar për ndihmën e propozuar në rastet e ndihmës individuale e paraparë në skemën e ndihmës shtetërore të miratuar paraprakisht nga Komisioni; dhe

2.3. brenda njëzet (20) ditëve të punës në rastet e modifikimit të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore.

3. Afati kohor i paraqitur në paragrafin 2 të këtij neni fillon të llogaritet nga dita vijuese, pas konfirmimit me shkrim nga Departamenti për pranimin e njoftimit të plotë.

4. Kur Komisioni nuk merr vendim gjatë periudhave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, dhënësi i ndihmës shtetërore ka të drejtë të vërë në zbatim planin e ndihmës shtetërore. Paraprakisht, dhënësi e njofton me shkrim Departamentin për këtë veprim.

5. Vendimi i Komisionit merret me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

6. Vendimet e Komisionit i dorëzohen dhënësit të ndihmës. Ato publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në ueb faqen e Komisionit.

Neni 15 **Vlerësimi i përputhshmërisë së ndihmës shtetërore**

1. Në rast se Departamenti vlerëson mospërputhshmërinë e ndihmës shtetërore me këtë Ligj:
 - 1.1. njofton për këtë dhënësin e ndihmës dhe përfituesin, dhe i kërkon informata shtesë brenda tridhjetë (30) ditëve;
 - 1.2. fton publikisht palët e interesit që t'i paraqesin komentet e tyre në formë të shkruar tek Departamenti, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit; dhe
 - 1.3. propozon nga Komisioni të marrë vendim sipas nenit 14 të këtij Ligji.
2. Komentet e marra nga palët e interesit, sipas paragrafit 1.2 të këtij neni, paraqiten tek dhënësi i ndihmës shtetërore, nëse kërkohet, pa e zbuluar identitetin e autorit të tyre. Dhënësi i ndihmës shtetërore mund t'i paraqes argumentet e tij Departamentit brenda tridhjetë (30) ditëve pasi është vënë në dijeni për komentet e palëve të interesit.

Neni 16 **Revokimi i ndihmës shtetërore**

1. Nëse ndihma shtetërore është dhënë pa vendimin paraprak të Komisionit sipas nenit 14 të këtij ligji, Departamenti fillon procedurat për ndihmë të kundërligjshme.
2. Nëse Departamenti, me iniciativën e tij, me kërkesë të Komisionit apo në bazë të informatave nga palët e interesit, merr të dhëna për ndihmën e kundërligjshme, ajo kërkon nga dhënësi i ndihmës shtetërore të kundërligjshme të paraqesë të gjitha të dhënat për ndihmën në fjalë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune.
3. Në rast se për ndihmën e ndarë nga dhënësi i ndihmës, nuk paraqiten të dhëna të nevojshme, të përcaktuara nga Departamenti, ose nëse ofrohen informacione jo të mjaftueshme, atëherë Departamenti përsërit kërkesën për paraqitjen e informacioneve të domosdoshme, duke vendosur edhe një afat të ri kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune.
4. Nëse brenda afatit të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni dhënësi i ndihmës nuk paraqet të dhënat e kërkuara, Komisioni kërkon nga dhënësi i ndihmës shtetërore që të pezullojë dhënien e ndihmës.
5. Dhënësi i ndihmës shtetërore, pasi të ketë pranuar kërkesën e Komisionit për pezullim të ndihmës shtetërore, ndërprejë dhënien e ndihmës dhe, për këtë, informon me shkrim Departamentin.

6. Komisioni urdhëron revokimin e ndihmës, në rast se vlerësohet se ndihma shtetërore nuk është në pajtim me dispozitat në fuqi për ndihmën shtetërore. Kthimi i ndihmës së kundërligjshme bëhet së bashku me një normë mesatare të interesit të përcaktuar nga Komisioni dhe llogaritet nga dita kur ndihma e kundërligjshme ka qenë në dispozicion të përfituesit, deri në datën e kthimit.

Neni 17

Parashkrimi i ndihmës shtetërore të kundërligjshme

1. Komisioni, mund të kërkojë kthimin e ndihmave të kundërligjshme, brenda një periudhe dhjetë (10) vjeçare, nga momenti i dhënies së ndihmës shtetërore.
2. Afati i parashkrimit fillon ditën, në të cilën ndihma e kundërligjshme i është dhënë përfituesit të saj, si një ndihmë individuale apo si një skemë e ndihmës shtetërore. Çdo veprim i ndërmarrë nga Komisioni ose nga dhënësi i ndihmës, që vepron me kërkesën e Komisionit, në lidhje me ndihmën e kundërligjshme, ndërpret afatin kohor. Çdo ndërprerje shkakton rifillimin e llogaritjes së afatit të parashkrimit. Nëse vendimi i Komisionit është apeluar në gjykatën kompetente, afati i parashkrimit pezullohet deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.
3. Çdo ndihmë, së cilës i ka kaluar afati i parashkrimit, vlerësohet ndihmë ekzistuese.

Neni 18

Revokimi i vendimit

1. Komisioni revokon vendimin për miratimin e një ndihme shtetërore, nëse pas miratimit konstaton se vendimi është mbështetur në informata të pasakta të dhënësit, që kanë qenë të rëndësishme në marrjen e vendimit apo nuk është duke u shfrytëzuar në përputhje me vendimin e Komisionit.
2. Para revokimit të vendimit dhe marrjes së vendimit të ri, Komisioni verifikon argumentet e dhënësit dhe të palëve të interesit.

Neni 19

Skemat ekzistuese të ndihmës

1. Dhënësit e ndihmës janë të detyruar, që brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesin pranë Departamentit, të gjitha të dhënat për skemat ekzistuese të ndihmës.
2. Komisioni propozon masa adekuate për të siguruar që çfarëdo skeme ekzistuese e ndihmës të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Sipas kësaj, Komisioni mund të kërkojë ndërprerjen e ndihmës ekzistuese dhe të vendosë për fillimin e hetimeve lidhur me ndihmë të kundërligjshme, nëse:

2.1. Informacionet shtesë shtojnë dyshimin për mospërputhje të ndihmës shtetërore me dispozitat e këtij ligji dhe dhënësi i ndihmës nuk i zbaton masat e nevojshme të propozuara nga Komisioni;

2.2. Ndihma shtetërore nuk është ndarë sipas kushteve të përcaktuara në vendimin e Komisionit;

2.3. Dhënësi i ndihmës shtetërore nuk siguron informacione shtesë brenda një afati të përshtatshëm kohor të caktuar nga Departamenti.

3. Komisioni, pasi shqyrton ankesat e parashtruara me shkrim nga palët e interesit, si dhe të dhënat tjera lidhur me ndihmën shtetërore, verifikon të dhënat që përfshihen, vlerëson rëndësinë e këtyre informacioneve dhe merr vendimin, sipas nenit 14 ose sipas nenit 16 paragrafi 6. të këtij ligji.

Neni 20

Ankesa kundër vendimit të Komisionit

1. Përrjashtimit dispozitative në fuqi për procedurën administrative, vendimi i marrë nga Komisioni është vendim përfundimtar në procedurën administrative.

2. Përfituesi, dhënësi apo pala e tretë që ka interes mund të iniciojnë procedura gjyqësore kundër vendimit të Komisionit.

3. Procedura kundër vendimit të marrë nga Komisioni iniciohet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, në Gjykatën Themelore, Departamenti për çështje administrative.

4. Procedura gjyqësore sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Komisionit.

Neni 21

Raporti vjetor i Ndihmës Shtetërore

1. Dhënësi i ndihmës shtetërore, brenda tre (3) muajve pas mbarimit të vitit kalendarik, gjatë të cilit është ndarë ndihma shtetërore, i paraqet Departamentit Raportin vjetor të Ndihmës Shtetërore lidhur me ndarjen e ndihmës gjatë vitit paraprak.

2. Në rast se Departamenti, pas shqyrtimit të të dhënave të Raportit Vjetor të Ndihmës Shtetërore ose çfarëdo informacioni që paraqitet nga dhënësi i ndihmës shtetërore, dyshon se ndihma nuk është dhënë në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, atëherë kërkon nga dhënësi të sigurojë të dhënat që mungojnë. Brenda një (1) muaji nga data e dorëzimit të raportit vjetor, Departamenti përcakton se cilat të dhëna mungojnë dhe kërkon dorëzimin e tyre.

3. Komisioni, çdo vit deri më 30 shtator miraton Raportin Vjetor të Ndhmës Shtetërore dhe ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Raporti përfshin informacione për vendimet e marra nga Komisioni, shumën e përgjithshme të ndihmës së dhënë, si dhe shpërndarjen e ndihmës nëpërmjet skemave të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale. Po ashtu, raporti përfshin të dhënat për ndihmat e dhëna në sektorin e agrikulturës dhe të dhënat për de minimis.

Neni 22

Nxjerrja e akteve nënligjore

Për zbatimin e këtij ligji Qeveria me propozimin e Ministrisë së Financave, miraton aktet nënligjore, në afat prej gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, përveç në rastet kur është paraparë ndryshe me këtë Ligj.

Neni 23

Dispozitat kalimtare

1. Procedurat e filluar sipas Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore para shfuqizimit të këtij ligji, vazhdojnë sipas procedurave dhe afateve të parapara me këtë Ligj.

2. Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, ndarja buxhetore për Zyrën për Ndhmë Shtetërore, e cila funksionon në kuadër të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, barten në Ministrinë e Financave, konform nenin 31 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Zyra e Ndhmës Shtetërore, në kuadër të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, shuhet dhe punëtorët e kësaj zyre barten në Departamentin e Ndhmës Shtetërore, në kuadër të Ministrisë së Financave.

Neni 24

Dispozitat kalimtare mbi Komisionin e Ndhmës Shtetërore

1. Përjashtimisht nga neni 9 i këtij ligji, deri më 31 dhjetor 2017 Komisioni i Ndhmës Shtetërore do të jetë në përbërje si në vijim:

1.1. Ministri i Financave - kryesues;

1.2. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës-anëtar;

1.3. Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës - anëtar;

1.4. Përfaqësuesi i Asociacioneve të Komunave - anëtar; dhe

1.5. Përfaqësuesi i shoqërisë civile -anëtar.

2. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në Komision ka mandat katër (4) vjeçar. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes përcaktohen me akt nënligjor.

3. Auditori i Përgjithshëm ose përfaqësuesi i tij/saj merr pjesë në takimet e Komisionit në cilësinë e vëzhguesit.

4. Komisioni miraton Rregulloren e Punës, ku përcaktohet organizimi, procedurat administrative të vendimmarrjes si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit.

Neni 25 Dispozitat shfuqizuese

1. Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore.

2. Aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore do të mbeten në fuqi nëse nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, derisa të shfuqizohen me aktet nënligjore të reja.

Neni 26 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-100
23 dhjetor 2016**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI